



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Prill, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Përkundër sfidave të mëdha që ka paraqitur përhapje e pandemisë COVID-19, Drejtoria e Arsimit gjatë muajit prill, me përkushtim të madha ka arritur t'i realizojë punët dhe detyrat e shumta, të parapara sipas planit të veprimit dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura, në funksion të proceseve arsimore.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trupë në sigurim të cilësisë;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;

- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Hartimi i Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Zbatimi i Planit për zhvillimin profesional;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante, për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondit për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtorin, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës në shkollë për punëtorin, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave monitorues për përdorimin e kabineteve;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;

- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonimë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizimi i ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;

- Dërgimi në prokurim i specifikacionit “Furnizimi me material didaktik i institucioneve arsimore”;
- Dërgimi në prokurim i specifikacionit “Furnizimi me drurë dekorativ i shkollave”;
- Dërgimi në prokurim i specifikacionit “Furnizimi i shkollave me material higjienik”;
- Dërgimi në prokurim i specifikacionit “Furnizimi me libra i bibliotekave shkollore”;
- Furnizimi me inventar i disa shkollave etj.;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA


Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit përmes platformave digjitale, duke i përcjellë ecuritë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- **Mësimi në distancë**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim dhe bashkëveprim me Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe mekanizma të tjerë mbështetës, kanë arritur që gjatë muajit prill të zhvillojnë dhe zgjerojnë kapacitetet e mësimit në distancë. Pra, në



nivelin e arsimit fillor (I-V), përpos lëndës së Gjuhës shqipe dhe Matematikës, janë përgatitë dhe transmetua në RTK edhe mësimet për lëndën Edukatë qytetare dhe Njeriu dhe natyra, ndërsa në nivelin e mesëm të ulët (VI-IX), përveç lëndës së Gjuhës shqipe dhe Matematikës, në muajit prill janë



rritur kapacitetet dhe ka filluar mësimi edhe për këto lëndë: Gjeografi, Histori, Edukatë qytetare, Kimi, Fizikë, Biologji dhe TIK.

Po ashtu, gjatë muajit prill për mësimin në distancë janë vendosur kriteret dhe standarde të larta që garantojnë mësim cilësor, janë hartuar planifikimet për muajt prill, maj dhe qershor, nga Ekipi profesional, në bashkëpunim me mësimdhënësit, janë caktuar në këtë proces edhe 14 auditorë (kontrollues), të materialeve dhe xhirimeve, një lektor dhe një koordinator i cilësisë, duke e vendosur dhe siguruar kualitet në procesin e mësimdhënies. Pra, në procesin e mësimdhënies Drejtoria e Arsimit gjatë këtij muajit ka angazhuar dhe mobilizuar mbi 120 mësimdhënës, të cilët janë duke e realizuar punën dhe detyrën e caktuar me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë. Pra, më 22 prill është finalizua procesi i xhirimeve mbi lëndët e lartcekura, ku për një periudhë të shkurtër nga mësimdhënësit tanë janë realizuar mbi 1800 video-incizime. Po ashtu, Drejtoria e Arsimit ka përcjellë planet mësimore për muajin prill, maj dhe qershor edhe për lëndët Edukatë muzikore dhe Gjuhë angleze, e që pritet së shpejti të transmetohen edhe këto lëndë në televizionin publik RTK;

- Përveç mësimin online, që nxënësit e klasave (VI-IX) janë duke e marrë nga RTK, Komuna e Prishtinës tanimë ka përpiluar edhe orarin e konsultimeve të mësimdhënësve me nxënësit e tyre, në koordinim me e-mësimin nga MASHTI. Për këtë janë planifikuar takimet përmes platformave "Zoom" dhe "Google classroom", një herë në javë nga secila lëndë mësimore, ku do të konsultohen për paqartësitë eventuale të nxënësve dhe konsultimet për detyrat e shtëpisë;
- Drejtoria e Arsimit, më 13 prill 2020, ka realizuar takim përmes platformës digjitale "Zoom", me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, për t'i informuar në detaje për platformën "e-Shkollori", që tani në këtë platformë ka filluar me procesimin e të dhënave dhe funksionalizimi e saj në shkollat tona. Andaj, duke i parë vështirësitë në monitorimin e mësimdhënësve, në komunikim nxënës-mësimdhënës dhe problematikën e vlerësimit, DKA-ja për të lehtësuar këtë proces, ka vendosur që nga mesi i muajit prill t'iu krijon qasje

të gjithë drejtorëve dhe mësimitdhënësve në platformë dhe menjëherë të fillojnë me detyrat të cilat ju caktohen;

- **Organizimi i trajnimeve përmes platformës “Zoom”**

Kompania “IILLYRIANI”, komfor marrëveshjes që ka lidhur me Komunën e Prishtinës, gjatë muajit prill ka arritur të trajnojë përmes platformës digjitale “Zoom”, drejtorët e shkollave dhe ca mësimitdhënës përgjegjës të caktuar nga shkolla, për platforme “e-Shkollori”, duke i përgatitur për implementim dhe zbatim e saj në praktikë.

Për këtë platformë janë përgatitur një pjesë e stafit të Drejtorisë së Arsimit, ku në vazhdimësi do të përcjellin punët dhe detyrat që do të realizohen në secilën shkollë;

- Drejtoria e Arsimit, më 21 prill 2020, ka realizuar takim me psikologët e shkollave, ku janë trajtuar çështje të ndryshme, e veçanti mundësia e tyre për t’i mbështetur nxënësit e shkollave të komunës së Prishtinës me këshilla profesionale, në këto rrethana që po kalon vendi si pasoj e pandemisë COVID-19;

- Drejtoria e Arsimit, më 27 prill 2020, ka realizuar takimin e radhës me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore përmes platformës digjitale “Zoom”, ku në këtë takim është trajtuar çështja e ecurisë dhe mbarëvajtjes së mësimit online, aktivitetet e realizuara lidhur me platformën “e-Shkollori”, në veçanti procesi i vlerësimit të nxënësve në distancë. Pra, për vlerësimin e nxënësve në distancë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka përgatitur udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve në distancë, gjatë pandemisë COVID-2019, dhe për këtë çështje ka nxjerrë edhe vendimin, me të cilin i obligon të gjitha institucionet arsimore të veprojnë komfor tij;

- **Asociacioni i drejtorëve**

Bazuar në një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi gjendjen aktuale në procesin e udhëheqjes dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe ngritjen e cilësisë në këtë segment, është identifikuar se reforma në nivelin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, në këtë fazë ka nxjerrë në pah elemente sfiduese, se në këtë fazë ka nevojë për krijimin e një trupi mbështetës, profesional për avancimin dhe sigurimin e cilësisë në udhëheqje dhe menaxhim të institucioneve edukativo-arsimore për ngritjen e performancës në arsim. Pra, ky trup mbështetës do të jetë *Asociacioni i Drejtorëve të Shkollave*, që rolin kyç do ta ketë sigurimin e cilësisë në shkolla.

Drejtoria e Arsimit përkundër sfidave, është e vendosur dhe e përkushtuar që nivelin e udhëheqjes dhe menaxhimit në institucionet edukativo-arsimore, të ngre në nivelin dhe standardin e kërkuar, sepse përmes këtij trupit profesional synohet të ndërtojmë sistem të mirë të udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim, duke qenë në harmoni me trendët e shteteve të zhvilluara evropiane, duke ngritur dhe përmirësuar performancën e udhëheqjes.

Andaj, për t’ju përgjigjur profesionalisht kërkesave për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve drejtuese, Drejtoria e Arsimit, duke u mbështetur në Ligjin për

vetëqeverisjes lokale dhe Ligjin për Arsimin në komuna, nr.03/L-068, ka bërë gjitha përgatitjet e duhura për formimin e Asociacionit të Drejtorëve.

Drejtoria e Arsimit, duke ditur rolin dhe ndikimin e madh që do ta ketë Asociacioni i Drejtorëve, në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në udhëheqje dhe menaxhim të shkollave, ka vendosur standarde, ku anëtarët drejtues të këtij asociacionit duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- 1.1. Përgatitje shkollore së paku 240 ETCS 4 vite, profili arsimor;
 - 1.2. Përvoja e punës në udhëheqje dhe menaxhim të institucioneve arsimore më shumë se 4 vjet;
 - 1.3. Njohës i mirë i sistemit të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe vendimeve);
 - 1.4. Trajner për udhëheqje dhe menaxhim, të ketë të përfunduar trajnime të cilat janë të licencuar dhe akredituara nga MASHTI;
 - 1.5. Punët dhe detyrat e realizuara si drejtues, të cilat kanë reflektuar pozitivisht në procesin e udhëheqjes dhe menaxhimit;
 - 1.6. Shkathtësi në komunikim dhe punë ekipore;
 - 1.7. Shkathtësi analitike dhe organizative;
 - 1.8. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi;
 - 1.9. Hartues i projekteve për thithjen e donacioneve të ndryshme.
- Pavarësisht situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, Drejtoria e Arsimit asnjëherë nuk ka ndalur së operuari, gjithnjë në funksion të krijimit të kushteve dhe mundësive më të mira për nxënësit tanë, duke siguruar e krijuar ambiente të këndshëm, me një infrastrukturë shkollore sipas kushteve dhe standardeve të larta, ku mund të ofrohet dhe zhvillohet mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.



Pra, gjatë muajit prill është intervenuar në renovimin e nyjave sanitare në shkollën fillore "Asim Vokshi", ndërrimi i dritareve të institucionit parashkollor "Lulevera", ndërsa në gjimnazin "Eqrem Çabej", është bërë intervenimi në infrastrukturën e brendshme shkollore, duke u mundësuar

nxënësve me karrocë qasje dhe ndjekjen e mësimëve kabinetike dhe duke ofruar mundësi të barabarta shkollimi për të gjithë nxënësit;

- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar përmes platformave digjitale, duke trajtuar çështje të ndryshme në interes të proceseve arsimore në kohën që po kalojmë;

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Komuna e Prishtinës në funksion të organizimit të mësimit në distancë, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë “ILLYRIAN SHPK NUI”, me qëllim implementimin e platformës “E-shkollori” në nivelin e arsimit (VI-IX), platformë që nënkupton menaxhim digjital të sistemit shkollor, duke ofruar këto shërbime: mbarëvajtjen e mësimit, mësimdhënies, mësimnxënies, notimi, vërejtjet, vlerësimet, statistika, raportime narrative, njoftimet etj.

Kjo marrëveshje lidhet me kompaninë “ILLYRIAN” dhe Komunën e Prishtinës, në kuadër të implementimit të projektit “e-Shkollori”, për nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX), për vendosjen e platformës së standardizuar për realizimin e mësimit në distancë.

Pra, kjo platforme do të implementohet si shtesë për nxënësit e arsimtarët në këtë fazë të ngritjes së nivelit të emergjencës me rastin e pandemisë COVID-19, por sigurisht se do të jetë një platformë e standardizuar dhe që do të përdoret edhe në të ardhmen;

- Drejtoria e Arsimit, për vitin akademik 2019-2020, ka bërë ndarjen e 116 bursave për studentët e komunës së Prishtinës, të cilët studiojnë në universitetet publike;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit prill;
- Furnizimi me inventar i disa institucioneve edukativo-arsimore;
- Janë në procedurë të prokurimit disa projekte, si: furnizimi me material higjienik, furnizimi me material didaktik, furnizimi me inventar, furnizimi i shkollave me drurë dekorativë, furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike etj.;
- Janë furnizuar institucionet edukativo-arsimore me lëndë djegëse për ngrohje;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Hartimi i Planit për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Organizimi dhe mbajtja e Garave të diturisë, për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, prill-2020

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar prill-2020				
Kategoria ekonomike	Alokim	Shpenzim	Zotim -Oblig.	Mbetje -S=
Paga	1,547,679.05	1,547,679.05	-	-
Komunali	339,321.05	155,910.35	4,842.32	178,568.38
10-MSH	790,916.83	314,653.34	68,090.98	408,172.51
21-MSH	251,901.71	5,800.00	50,541.89	195,559.82
Subvencione	19,750.00	5,030.00	-	14,720.00
Donacione	79,515.62	-	-	79,515.62
Huaja-Grant i BB	-	-	-	-
FB-10-Kapitale	-	-	-	-
FB-21-Kapitale	318,610.22	74,861.05	-	243,749.17
FB-22-Kapitale	3,023,618.11	34,704.00	-	2,988,914.11
Totali:	6,371,312.59	2,138,637.79	123,475.19	4,109,199.61

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit prill ka realizuar mbi 30 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit prill të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministren e Arsimit dhe zëvendësministrat;
- zyrtarët e MASHTI;
- përfaqësuesit e LUX-DEV;
- përfaqësuesit e Zyrës japoneze.

4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit prill, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit prill janë pranuar gjithsej 64 lëndë, prej tyre të refuzuara 1 lëndë, të pezulluara 1 lëndë dhe në proces janë edhe 62 lëndë.

6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë:

- Përhapja e pandemisë COVID-19;
- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;

- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i kurrikulës së re.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.:

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësisë, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të Drejtorëve të Shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;

- Organizimi dhe mbajtja e Garave të diturisë, për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante, për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollës për mjete të TIK-së;
- Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-së;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti etj. në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;

- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2019-2020;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektive;
- Indeksi i sigurisë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektive;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përfundimi i procedurave të vlerësimit për disa projekte : furnizimi i shkollave me material higjienik, furnizimi i shkollave me material didaktik, furnizimi i shkollave me inventar, furnizimi i shkollave me drurë dekorativë, furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike, furnizimi i shkollave me perde, furnizimi i shkollave me makina pastrimi etj.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.